

## Federata e Tenisit e Kosovës

### Rregullore për sistemin e poentimit për vitin 2015

#### Poentimi për Tenisin e Kuq, Portokall dhe Gjelbërt (Red, Orange&Green)

- **Tenisi i Kuq (Red Tennis)** luajnë në grup Round-Robin nga 1(një) tie-break deri në 7 poena. Dy të parët e grupit kualifikohen për fazën finale ku luhet deri në 2(dy) tie-break deri në 7 poena apo eventualisht tie-breku i tretë deri në 7 poena.
- **Tenisi i Portokalltë (Orange Tennis)** luajnë në grup Round-Robin nga 1(një) tie-break deri në 10 poena. Dy të parët e grupit kualifikohen për fazën finale ku luhet deri në 2(dy) tie-break deri në 10 poena apo eventualisht tie-breku i tretë deri në 10 poena.
- **Tenisi i Gjelbërt (Green Tennis)** luajnë nga dy seta të fituara. Një set përfundon kur njëri tenisit arrin tek 4 gema të fituara. Tek rezultati 3-3 në gema luhet tie-break deri në 7 poena. Seti i tretë eventual luhet si tie break set deri në 7 poena.

#### Poentimi për Kategoritë U-12 & U-14

- U-12 dhe U-14 luajnë nga dy seta të fituara. Një set përfundon kur njëri tenisit arrin tek 4 gema të fituara. Tek rezultati 3-3 luhet tie-break deri në 7 poena. Seti i tretë eventual luhet si tie break set deri në 7 poena.

#### Poentimi për Kategoritë U-16 & U-18

- U-16 dhe U-18 luajnë në gjyrotë e para (1)një set të fituar deri në 6 gema të fituara. Në fazën finale organizatori mund të vendos mvarësisht prej numrit të tenistëve dhe numrit të takimeve të luajtura në të njejtën ditë për kalimin në sistemin me 2 seta të fituar. Seti i tretë luhet tie-break deri në 10 poena.

#### Poentimi për kategorinë Senior

- Seniorët luajnë nga (dy)2 seta të fituar deri në 6 gema. Seti i tretë eventual luhet si set i tërë apo nëse organizatori vendos që për shkak të motit, kohës apo rrethanave tjera të luhet si tie-break set deri në 10 poena.

#### Poentimi për kategorinë Veteran

- Veteranët luajnë nga (dy)2 seta të fituar deri në 6 gema. Seti i tretë eventual luhet si tie-break set deri në 10 poena.